



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:090929 **C. nr. 1016/2020**  
Datë: 09.02.2021  
Numri i dokumentit: 01490388

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike sh.a (KEDS), kundër të paditurit A.Sh., nga Prizreni, Rr. “.....”, ..... për kompensim dëmi, jashtë seance, me datë 09 Shkurt 2021, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**  
(Në bazë të mosbindjes)

Miratohet kërkesëpadia e paditëses KEDS, në Prishtinë.

Detyrohet i padituri A.(A).Sh., nga Prizreni, në emër të dëmit të shkaktuar, t'i paguan paditëses KEDS shumën 3.206,17 €, me kamat vjetore 8 %, nga data e parashtrimit të padisë, datë 03 Gusht 2020, deri në pagesën definitive. Si dhe të paguan shpenzimet e procedurës në shumën prej 20.00 €, të gjitha këto brenda 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Paditësja me padinë e paraqitur kundër të paditurit, ka kërkuar nga gjykata miratimin e kërkesëpadisë në atë mënyrë që të detyrohet i padituri A.(A).Sh., nga Prizreni të paguan shumën 3.206.17 €, në emër të dëmit të shkaktuar.

Në padinë e parashtruar, paraqet se me Aktgjykimin P. nr. 1300/2018 datë 10.09.2019, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 22.10.2018, i padituri A.(A).Sh., nga Prizreni është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 i Kodit Penal të Kosovë.

Sqarojnë që sipas llogaritjes që kanë bërë dhe atë sipas faturës për rikthimin e humbjeve vlera e dëmit që i është shkaktuar paditëses është 3.206,17 €.

Gjykata një kopje të padisë dhe provave të bashkangjitura padisë i ka dorëzuar palës së paditur me vërejtje për dhënien e përgjigjes në padi, duke e udhëzuar palën e paditur që të paraqet përgjigje me shkrim, në padinë e palës paditëse. Ndërsa në anën tjetër edhe e ka njoftuar për pasojat e mosveprimit sipas asaj vërejtje.

Pasi që pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në padi si dhe duke pasur parasysh faktin se themelësia e kërkesë padisë del nga faktet e treguara në padi dhe të njëjtat nuk janë në kundërshtim me provat e administruara, gjykata në kuptim të nenit 150 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi që të miraton kërkesëpadinë e palës paditëse.

Gjithashtu bazë për miratimin e kërkesëpadisë, gjykata vlerësoi dëmin të cilin i është shkaktuar palës paditëse me kryerjen e veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale, si

dhe faturës për rikthimin e humbjeve. Ashtu siç përcaktohet edhe me nenin 136 par. 1 lidhur me nenin 169 par. 3 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ashtu që edhe miratoi shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se shuma prej 3.206,17 €, është reale sipas llogaritjes së bërë e cila është në përputhje me nenin 31 par. 1 dhe 2 të Rregullave për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Gjykata vendosi që pala paditur të paguan kamatën vjetore prej 8 % nga data 18.04.2018, deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në kuptim të nenit 452 të LPK-së, duke miratuar shumën prej 20,00 € për taksa gjyqësore për padinë e paraqitur.

Nga arsyet e Cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
C. nr. 1016/2020 datë 09 Shkurt 2021

**G j y q t a r i**  
Atdhe Berisha

**UDHËZIME PËR ANKESË:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2020:090929  
Datë: 09.02.2021  
Numri i dokumentit: 01490388